

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: HISTORI-GJEOGRAFI

VENDLINDJA

Klasa e pestë

VITI SHKOLLOR 2008-2009

Tiranë, 2007

STRUKTURA KURRIKULARE

35 JAVË x 2 ORË = 70 ORË

NJOHURI TË REJA	34 ORË
PUNË PRAKTIKE DHE ESKURSIONE	24 ORË
PËRSËRITJE	6 ORË
KURRIKUL E LIRË (DISPOZICION)	6 ORË

	70 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 1: PËRSHKRIMI I TIPAREVE TË QËNDRËS TUAJ URBANE.

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë dhe të përshkruajë me fjalët e tij elementët kryesor përbërës të qendrës urbane në të cilën jeton;
- Të shpjegojë hartën topografike të qendrës urbane;
- Të dallojë dhe të përshkruajë tiparet kryesore të banesave në qendrën urbane;
- Të përshkruajë rrugët kryesore, mjediset e punës, të argëtimit, të jetës sociale e kulturore të qytetit.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Përshkrimi i hartës topografike të qendrës tuaj urbane duke respektuar tiparet kryesore (planvendosja, pozita gjeografike).
2. Karakteristikat kryesore të banesave në qytetin tuaj.
3. Paraqitja dhe vendosja e tyre në qytet.
4. Mjediset e punës në qytetin tuaj.
5. Mjediset e gjelbra në qytetin tuaj.
6. Objektet ku kryen veprimtaritë social-kulturore në qytetin tuaj.
7. Mjedisë dhe objekte të tjera (arkeologjike, historike dhe argëtuese etj.)

KOHA : 7 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 2: TIPARET E ZONËS SUAJ RURALE .

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë dhe të përshkruajë me fjalët e tij elementët kryesor përbërës të zonës rurale në të cilën jeton;
- Të shpjegojë hartën topografike të zonës rurale;
- Të dallojë dhe të përshkruajë tiparet kryesore të banesave të fshatit;
- Të përshkruajë rrugët kryesore, mjediset e punës, të argëtimit, të jetës sociale e kulturore të fshatit.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Përshkrimi i hartës topografike të zonës tuaj rurale.
2. Karakteristikat kryesore të banesave në fshatin tuaj.
3. Oborret si tipar i veçantë i fshatit tuaj.
4. Rrugët dhe roli i tyre në fshatin tuaj.
5. Mjediset e punës në fshatin tuaj.
6. Objektet historike dhe social-kulturore si pjesë përbërëse e jetës në fshatin tuaj.
7. Pasuritë pyjore dhe minerale që zotëron fshati juaj.

KOHA : 7 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 3: POPULLSIA NË QYTETIN TUAJ.

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë strukturën moshore të popullsisë në qytetin ku jeton
- Të shpjegojë nga ana statistikore rritjen e popullsisë në qytetin ku jeton;
- Të përshkruajë mënyrën e jetesës së popullsisë në qytet
- Të flasë për llojet e ndryshme të punëve që kryhen në qytetin e tij;
- Të flasë për disa nga faktorët historik e shoqëror që kanë ndihmuar në zhvillimin e qytetit të tij

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Statistika. për popullsinë në qytetin tuaj. Lindshmëria dhe vdekshmëria, rritja natyrore e popullsisë.
2. Mënyra e jetesës së grupeve të popullsisë në qytetin tuaj.
3. Llojet kryesore të punëve në qytet . Veprimtaritë dhe qendrat kryesore prodhuese në qytet.
4. Lëvizjet e popullsisë. Migrimet dhe emigrimet në periudha të ndryshme historike.
5. Të njohim fqinjët tanë. Tiparet kryesore të zonave fqinje me qytetin tonë.
6. Përparësitë që ofron mjedisi unë në zhvillimin ekonomik.

KOHA : 6 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 4: POPULLSIA NË FSHATIN TUAJ.

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë strukturën moshore të fshatit ku jeton
- Të shpjegojë nga ana statistikore rritjen e popullsisë në fshatin ku jeton;
- Të përshkruajë mënyrën e jetesës së popullsisë në fshat
- Të flasë për llojet e ndryshme të punëve që kryhen në fshatin e tij;
- Të flasë për disa nga faktorët historik e shoqëror që kanë ndihmuar në zhvillimin e fshatit të tij

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Statistika për popullsinë në fshatin tuaj. Lindshmëria dhe vdekshmëria, rritja natyrore e popullsisë.
2. Mënyra e jetesës së grupeve të popullsisë në fshatin tuaj.
3. Punësimi në fshatin tuaj dhe problemet e sotme.
4. Lëvizjet e popullsisë dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë proces në fshatin tuaj.
5. Të njohim fqinjët tanë. Tiparet e përbashkëta dhe të veçanta të fqinjëve të fshatit tuaj.
6. Burimet që ofron mjedisi i fshatit tuaj në zhvillimin ekonomik.

KOHA : 6 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 5 : TIPARET E MJEDISIT NATYROR.

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë relievin, tiparet e përgjithshme dhe elementët e veçantë në përbërje të tij
- Të flasë për klimën dhe të tregojë ndikimin e mikroklimës në mjedisin natyror ku jeton.
- Të dallojë dhe të përshkruajë veçantitë e botës bimore dhe shtazore dhe ndikimin e tyre në mjedisin tonë natyror.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Përbërësitë e mjedisit natyror.
2. Relievi, tiparet e përgjithshme dhe elementët përbërës të tij .
3. Klima dhe mikroklimat e mjedisit natyror lokal.
4. Ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe pasuritë pyjore.
5. Bimësia dhe bota shtazore. Elementët përbërës të florës dhe faunës.

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 6 : MJEDISI NATYROR DHE JETA E NJERËZVE

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë ndikimin e mjedisit natyror lokal në veprimtarinë e njeriut dhe anasjelltas, ndikimi i njeriut në mjedisin natyror.
- Të tregojë respekt për mjedisin natyror në të cilin jeton dhe elementët përbërës të tij.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Ndikimi i mjedisit natyror lokal në jetën e njerëzve që jetojnë në të.
2. Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror .
3. Respektimi i mjedisit natyror dhe elementët përbërës të tij.

KOHA : 3 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 7: HISTORIA E MJEDISIT RRETHUES (QYTETI YNË)

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përmendë dhe të flasë për historinë e vendlindjes, për ngjarjet më të rëndësishme dhe për figurat kryesore që kanë luajtur rol në historinë e qytetit të tij;
- Të flasë për rolin e qytetit në ngjarje të rëndësishme kombëtare
- Të flasë për pushtimet e huaja dhe ndikimin e tyre në jetën dhe historinë e qytetit
- Të përmendë institucionet kryesore qeverisëse në qytetin e tij dhe rolin e tyre në jetën e qytetit
- Të përmendë objekte të trashëgimisë kulturore në qytetin e tij

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Historiku i lindjes së qytetit tuaj.
2. Roli i qytetit tuaj në ngjarjet më të rëndësishme kombëtare.
3. Tiparet etnokulturore të qytetit tuaj.
4. Njohja me figurat më të rëndësishme në fushën e historisë, kulturës, arsimit etj. të qytetit tuaj.
5. Pushtimet e huaja dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e qytetit tuaj.
6. Institucionet qeverisëse dhe historiku i tyre
7. Roli i mjedisit që na rrethon në zhvillimet e reja kombëtare dhe ndërkombëtare.
8. Objekte të trashëgimisë kulturore në qytetin tuaj.

KOHA : 8 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 8 : HISTORIA E MJEDISIT RRETHUES (FSHATI YNË)

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përmendë dhe të flasë për historinë e vendlindjes, për ngjarjet më të rëndësishme dhe për figurat kryesore që kanë luajtur rol në historinë e fshatit të tij;
- Të flasë për rolin e fshatit të tij në ngjarje të rëndësishme kombëtare
- Të flasë për pushtimet e huaja dhe ndikimin e tyre në jetën dhe historinë e fshatit
- Të përmendë institucionet kryesore qeverisëse në fshatin e tij dhe rolin e tyre në jetën e fshatit
- Të përmendë objekte të trashëgimisë kulturore në fshatin e tij

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Historiku i lindjes së fshatit tuaj.
2. Roli i fshatit tuaj në ngjarjet më të rëndësishme kombëtare.
3. Tiparet etnokulturore të fshatit tuaj.
4. Njohja me figurat më të rëndësishme në fushën e historisë, kulturës, arsimit etj. të fshatit tuaj.
5. Pushtimet e huaja dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e fshatit tuaj.
6. Institucionet lokale dhe historiku i tyre
7. Roli i mjedisit që na rrethon në zhvillimet e reja kombëtare dhe ndërkombëtare.
8. Objekte të trashëgimisë kulturore në fshatin tuaj.

KOHA : 8 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 9: MBROJTJA E MJEDISIT QË NA RRETHON

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë botën bimore dhe shtazore të fshatit të tij
- Të dallojë tiparet kryesore të zhvillimit mjedisor lokal;
- Të dallojë faktorët që nxisin në kufizimin e hapësirave të gjelbëra në fshat
- Të bëjë përpjekje për ndërgjegjësimin e komunitetit në mbrojtje të mjedisit dhe të bashkëpunojë kuadrin e komunitetit me anëtarë të pushtetit lokal për ruajtjen e mjedisit

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Harta e florës dhe faunës në fshatit tuaj.
2. Zhvillimi i mjedisit lokal dhe elementët përbërës të tij.
3. Faktorët që ndikojnë në pakësimin e hapësirave të gjelbra në fshatit tuaj.
4. Roli i njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e pasurive bimore e shtazore.
5. Bashkëpunimi komunitet-qeverisje lokale për ruajtjen e pasurisë bimore e shtazore në fshatin tuaj.

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 10: MBROJTJA E MJEDISIT QË NA RRETHON

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij moduli nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë botën bimore dhe shtazore të qytetit të tij
- Të dallojë tiparet kryesore të zhvillimit mjedisor lokal;
- Të dallojë faktorët që nxisin në kufizimin e hapësirave të gjelbra në qytet
- Të bëjë përpjekje për ndërgjegjësimin e komunitetit në mbrojtje të mjedisit dhe të bashkëpunojë kuadrin e komunitetit me anëtarë të pushtetit lokal për ruajtjen e mjedisit

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Harta e florës dhe faunës në qytetit tuaj.
2. Zhvillimi i mjedisit lokal dhe elementët përbërës të tij.

3. Faktorët që ndikojnë në pakësimin e hapësirave të gjelbra në qytetin tuaj.
4. Roli i njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e pasurive bimore e shtazore.
5. Bashkëpunimi komunitet qeverisje lokale për ruajtjen e pasurisë bimore e shtazore në qytetin tuaj.

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 11 : INTERPRETIMI I HARTËS TOPOGRAFIKE TË MEDISIT TUAJ LOKAL.

Punë praktike: Njohja dhe interpretimi i hartës topografike sipas kriterëve të përcaktuara në legjendën e hartës për mjedisin tuaj lokal.

OBJEKTIVAT

Me anë të kësaj pune praktike nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të interpretojnë hartën topografike të mjedisit lokal ku jetojnë
- Të dallojnë vendndodhjen e qendrave arsimore, kulturore, të qeverisjes, rrugët, pasuritë pyjore dhe hapësirës së gjelbër të mjedisit tuaj.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Interpretimi i hartës topografike të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me elementët përbërës të hartës topografike si: qendra historike, lagjet e banimit, rrugët, ndërtesat arsimore, kulturore etj .
3. Vendndodhja e hapësirave dhe kurorës të gjelbër, agrikulturës dhe pyjeve në mjedisin tuaj lokal .
4. Interpretimi i hartës topografike të lagjes tuaj si pjesë përbërëse e mjedisit tuaj lokal.

Mjetet e nevojshme:

Harta topografike në shkallën 1: 50.000, 1: 25000,
Tregues harte, laps i zi, lapsa me ngjyra, vizore, gomë.

KOHA : 4 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 12 : NJOHJA NË TERREN E MJEDISIT QË NA RRETHON.

Punë praktike: Një vështrim i përgjithshëm i mbi tiparet e relievit të mjedisit tuaj lokal duke përfshirë klimën, llojet e shkëmbinjve, bimësinë, botën shtazore, mineralet dhe burimet e energjisë.

OBJEKTIVAT

Me anë të kësaj pune praktike nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë elementët përbërës të relievit përmes njohjes konkrete me terrenin.
- Të ushtrohet në matjen e temperaturës, njohjen e bimësisë, të maleve etj.
- Të dallojë dhe të krahasojë bimësinë e tokave nga ajo e maleve, si edhe të dallojë vendburimet minerale e energjetike të mjedisit lokal.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Njohja me elementët përbërës të relievit të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me llojet e shkëmbinjve, tokave, maleve si pjesë e rëndësishme e relievit.
3. Njohja me klimën dhe mikroklimat që veprojnë në mjedisin tuaj lokal .
4. Njohja me bimësinë dhe botën shtazore të mjedisit tuaj lokal.
5. Njohja me ujërat, burimet minerare dhe të energjisë në mjedisin tuaj lokal.

Mjetet e nevojshme:

Harta memece fizike e relievit, album i botës bimore dhe shtazore të rajonit, lapsa të zinj, lapsa me ngjyra, barometër i thjeshtë për matjen e temperaturës, copa të vogla shkëmbinjsh etj.

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 13 : NJOHJA ME TRASHËGIMINË HISTORIKE DHE ETNO-KULTURORE SI PJESË PËRBËRËSE E MJEDISIT QË NA RRETHON.

Punë praktike: Nxënësit do të njohin nga afër objektet me rëndësi të mjedisit lokal në fushën e trashëgimisë historike, etnokulturore, sociale si edhe të përcaktojnë vendndodhjen e tyre në mjedisin që i rrethon.

OBJEKTIVAT

Me anë të kësaj pune praktike nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë dhe të veçojë sipas llojit edhe periudhave objektet e trashëgimisë historike, për shembull:
 - Objekte të karakterit arkeologjik,
 - Objekte të karakterit historik mesjetar etj.
- Të dallojë si objekte historike monumente që flasin për ngjarje të rëndësishme të lidhura me mjedisin e tij, figura historike si edhe banesa karakteristike.

- Të përshkruajë historinë e qendrës historike të qytetit, vendndodhjen e objekteve kulturore.
- Të dallojnë objektet e kultit fetar të mjedisit lokal.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Njohja me objektet historike të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me ndërtesat e qeverisjes lokale apo qendrore që kanë vlera historike.
3. Njohja me objektet arkeologjike të mjedisit tuaj lokal .
4. Njohja me objektet kulturore dhe banesat karakteristike të mjedisit tuaj lokal.
5. Njohja me objekte të kultit fetar : kisha, xhami, teqe etj.

Mjetet e nevojshme :

Udhëzues lokal (guidë), foto të objekteve historike dhe arkeologjike, fletore shënimesh, lapsa, aparat fotografik, albume .

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 14 : NJOHJA ME AKTIVITETET PRODHUESE DHE ARGANEVE TË QEVERISJES LOKALE E QENDRORE TË MJEDISIT QË NA RRETHON.

Punë praktike: Njohja e nxënësve me qendrat ekonomiko-tregtare, industriale të mjedisit tuaj lokal . Të dalloj qendrat ekonomike nga ato qeverisëse lokale ose qendrore.

OBJEKTIVAT

Me anë të kësaj pune praktike nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë dhe të përshkruajë veprimtarinë prodhuese ekonomike, industriale dhe tregtare.
- Të përcaktojë vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore si edhe objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Njohja me qendrën apo rajonet tregtare të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me qendrën apo rajonet industriale të mjedisit tuaj lokal.
3. Njohja me arteriet kryesore të rrugëve lokale dhe kombëtare të mjedisit tuaj lokal
4. Njohja me objektet e qeverisjes lokale dhe qendrore.
5. Njohja me mjediset argëtuese dhe kulturore që i shërbejnë nxënësve në edukimin e tyre qytetar.

Mjetet e nevojshme:

Udhëzues lokal për qendrën ekonomike, tregtare dhe industriale. Fotografi të qendrave kryesore ekonomike, kulturore dhe argëtuese.

KOHA : 5 ORË

FUSHA: MJEDISI LOKAL

MODULI 15 : RINDËRTIMI I HISTORIKUT TË MJEDISIT QË NA RRETHON.

Punë praktike Të rindërtohet historiku i mjedisit lokal, përmes disa objekteve që na japin një pamje më të plotë të historisë së tij. Të nxitet nxënësi të njohë dhe të respektojë traditën historike të mjedisit ku jeton dhe atij kombëtar

OBJEKTIVAT

Me anë të kësaj pune praktike nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë dhe të kërkojë gjetjen e sendeve ose veglave që mund të ndihmojnë në kuptimin e historisë së mjedisit;
- Të ndërtojë një histori të shkurtër të mjedisit ku jeton përmes objekteve etnografike, veglave të punës, veshjeve ose figurave të ndryshme historike;

TEMATIKA E SUGJERUAR

1. Përshkrimi i përgjithshëm i historisë së mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me foto të ndryshme për historinë e krijimit të mjedisit lokal, harta të vjetra etj.
3. Njohja me figura të rëndësishme të historisë të mjedisit tuaj lokal .
4. Njohja me objekte etnografike, vegla pune, veshje, zbukurime etj..
5. Njohja e historikut të familjes tuaj si pjesë përbërëse e mjedisit tuaj lokal.

Mjetet e nevojshme:

Harta të vjetra të mjedisit lokal, foto të objekteve historike , veshje, objekte të trashëguara familjare etj.

KOHA : 5 ORË